

KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT

MARS 2026

RAPORTI I VEPRIMTARISË

2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT

Adresa: Rr “Reshit Çollaku”, Tiranë

Tel: 042 220 466 / 499

Site: www.kkk.gov.al

E_mail: kontabiliteti@kkk.gov.al

RAPORTI
i
VEPRIMTARISË

Viti 2025

Publikuar në Mars 2026

PËRMBATJA

1	Hyrje	1
2	Aktivitetet kryesore në vitin 2025	4
3	Informacion mbi SKK-të dhe SNRF-të	8
3.1	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të)	8
3.2	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNRF-të).....	9
4	Gjetje nga monitorimi i pasqyrave financiare.....	10
5	Plani i punës për vitin 2026.....	20
6	Çështje të tjera për rritjen e kapaciteteve dhe efektivitetit të punës së KKK-së	21
	Shtojcë A- Realizimi i treguesve të buxhetit dhe veprimtaria financiare për vitin 2025	22
	Shtojcë B - Buxheti i alokuar për vitin 2026	25
	Shtojcë C – Pasqyrat financiare 2025.....	28

1 Hyrje

Ky raport vjetor synon të ofrojë një pasqyrë të plotë, të strukturuar dhe transparente të veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit për vitin 2025, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor në fuqi. Nëpërmjet këtij raporti paraqiten aktivitetet kryesore të realizuara gjatë vitit, zhvillimet në përditësimin dhe harmonizimin e standardeve kombëtare me ato ndërkombëtare të raportimit financiar, si dhe gjetjet dhe problematikat e evidentuara nga procesi i monitorimit të pasqyrave financiare. Gjithashtu, raporti përfshin prioritetet dhe planin e punës për vitin 2026, në funksion të forcimit të rolit rregullator të Këshillit dhe rritjes së cilësisë së raportimit financiar në vend, në përputhje me kërkesat e procesit të integritetit evropian.

1.1 Prezantim i shkurtër i misionit dhe objektit të veprimtarisë

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, organizëm profesional, publik dhe i pavarur, ka për mision përmirësimin e vazhdueshëm të raportimit financiar të njësive ekonomike fitimprurëse dhe jofitimprurëse. Ky mision, i zbërthyer në objektiva të qarta, strategji të përshtatshme dhe plane pune të koordinuara, garanton transparencën dhe saktësinë e raportimeve financiare si kusht i panegociueshëm i cilësisë së vendimeve ekonomike të operatorëve të tregut.

Tre produktet kryesore që realizon Këshilli, në kuadër të realizimit të misionit të vet si dhe detyrave të ngarkuara nga ligji i kontabilitetit, janë:

- hartimi dhe përmirësimi i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit;
- përkthimi, pa ndryshime nga teksti origjinal dhe në kohë reale, i SNRF-ve;
- monitorimi i zbatueshmërisë së standardeve të raportimit financiar.

Gjithashtu, si një organizëm rregullator në fushën e raportimit financiar, KKK përpunon sistemin dhe metodat kontabël. KKK formulon udhëzimet përkatëse kontabël për përmirësimin e kuptueshmërisë së tyre nga përdoruesit apo hartuesit të raporteve financiare.

KKK me ligj ka detyrimin të kontribuojë me mendime dhe sygjerime në hartimin apo ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore të kësaj fushe, me propozime konkrete për kurrikulat universitare që mbulojnë fushën e kontabilitetit si dhe të publikojë materiale informuese dhe udhëzuese në zbatim të standardeve të raportimit financiar.

Gjatë vitit 2025 janë realizuar të gjitha detyrat e parashikuara në programin e punës të miratuar në Këshill në fillim të vitit, ku më kryesoret janë ato lidhur me hartimin e SKK-ve të reja, përmirësimin e atyre ekzistuese, përkthimin dhe publikimin e SNRF-ve si dhe detyra të tjera në kuadër të përmbushjes së kërkesave për rishikimin e legjislacionit të fushës së raportimit financiar në kuadër të procesit të integritit të Shqipërisë në BE.

1.2 Statusi, detyrat dhe organizimi

Statusi

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit është organizëm profesional publik i pavarur dhe gëzon personalitet juridik. Veprimtaria e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit financohet nga buxheti i shtetit. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit raporton pranë ministrit përgjegjës për financat, brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, në lidhje me veprimtarinë vjetore. Raporti ku trajtohen me hollësi edhe problemet e konstatuara gjatë monitorimeve në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare, si dhe zgjidhjet e sugjeruara, i dërgohen për informacion Bordit të Mbikëqyrjes Publike brenda po këtij afati.

Detyrat

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ka për detyrë:

- a) të hartojë standardet kontabël kombëtare, në përputhje me kërkesat e ligjit 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe në koherencë me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;
- b) të përpunojë një sistem kontabël, ku, përveç standardeve kombëtare të kontabilitetit, të përcaktojë rregullat për mbajtjen e kontabilitetit, si dhe formatet për pasqyrat financiare;
- c) të evidentojë nevojat dhe të propozojë zgjidhjet për përmirësimin e metodave kontabël për mbajtjen e kontabilitetit dhe për kualifikimet;
- ç) të interpretojë dhe të përgjithësojë problemet që dalin nga praktika dhe standardet kontabël, të cilat i paraqet në formën e udhëzimeve kontabël;
- d) të shqyrtojë dhe të japë mendime për të gjitha projektligjet dhe projektaktet nënligjore, rregulluese, të cilat përmbajnë dispozita për kontabilitetin, për përgatitjen e llogarive, që lidhen me njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, si dhe me profesionet me bazë kontabilitetin;

- dh) të vendosë marrëdhënie me organizata profesionale vendase e të huaja dhe të marrë pjesë në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare për kontabilitetin;
- e) të publikojë në faqen zyrtare të institucionit Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të detyrueshme për zbatim. Gjithashtu, ka të drejtën të publikojë edhe materiale të tjera, jo të detyrueshme për zbatim, me karakter dhe qëllim informues, në funksion të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare;
- ë) të botojë Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe materiale të tjera për zbatim në lidhje me këto standarde;
- f) të monitorojë zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar;
- g) të organizojë tryeza të rrumbullakëta, seminare, konferenca dhe të tjera të ngjashme me to, me qëllim rritjen e transparencës përmes përfshirjes së palëve të interesit në procesin e përmirësimit të raportimit financiar, informimin e palëve të interesit për zhvillimet në këtë fushë, si dhe nxitjen e zbatimit korrekt të SKK-ve/SNRF-ve nga njësitë ekonomike.

Përbërja dhe organizimi

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit përbëhet nga 7 anëtarë, prej të cilëve:

- a) një anëtar propozohet nga organizata profesionale e auditimit ligjor;
- b) një anëtar propozohet nga shoqatat profesionale të kontabilitetit;
- c) një anëtar propozohet nga dhomat e tregtisë (përfaqësues të njësive ekonomike të mëdha ose njësive ekonomike me interes publik) ose nga shoqata e bankave;
- ç) tre anëtarë propozohen nga ministria përgjegjëse për financat, ku njëri prej të cilëve është përfaqësues i strukturës përgjegjëse për administrimin e të ardhurave;
- d) një anëtar propozohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit mandatohen me urdhër të ministrit përgjegjës për financat dhe kanë mandat 4-vjeçar. Ata mund të rimandatohen vetëm një herë me miratimin e ministrit përgjegjës për financat.

Përbërja aktuale e Këshillit është:

Ilir Binaj – Kryetar

Dritan Fino – Nënkyetar

Mirjeta Emini – Anëtare

Aurela Velo – Anëtare

Aida Bediava – Anëtare

Fatmir Bërdica – Anëtar

Fatian Devija – Anëtar

2 Aktivitetet kryesore në vitin 2025

Në zbatim të Ligjit 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 24 “Statusi dhe detyrat” dhe VKM nr. 505, datë 17.7.2019 “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”, neni 2 “Objektivat, përgjegjësitë dhe detyrat e KKK-së”, gjatë vitit 2025, Këshilli realizoi:

1. Rishikimin e plotë të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 8 “Të ardhurat”

(Informacion më i zgjeruar jepet në rubrikën 3.1 (a) të këtij Raporti)

2. Rishikimin e udhëzuesit aktual të SKK8 me fokus të ardhurat nga kontratat e ndërtimit

(Informacion më i zgjeruar jepet në rubrikën 3.1 (b) të këtij Raporti)

3. Rishikimin e ligjit për kontabilitetin (çështja e raportimit të qëndrueshmërisë)

Gjatë vitit 2025, Këshilli ka qenë intensifikisht i përfshirë në procesin e rishikimit të Ligjit 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” me synim identifikimin dhe adresimin e problematikave në zbatimin e këtij ligji si dhe objektivin madhor të përmbushjes së detyrimeve të reja që rrjedhin nga zhvillimet e fundit të acquis communautaire të Bashkimit Evropian në fushën e raportimit financiar, raportimit të qëndrueshmërisë dhe transparencës fiskale.

Një nga ndryshimet kryesore lidhet me përfshirjen në ligj të kërkesave për raportimin e qëndrueshmërisë, në përputhje me Direktivën (BE) 2022/2464 (CSRD). Ky detyrim zbatohet mbi bazën e parimit të proporcionalitetit dhe u përket vetëm njësive ekonomike shumë të mëdha, të cilat, në datën e mbylljes së periudhës raportuese, tejkalojnë njëkohësisht mesataren vjetore prej 1,000 punonjësish dhe të ardhurat neto prej 450 milion euro, për të hyrë në fuqi në vitin 2028. Aktualisht, ligji i kontabilitetit në nenin 18 të tij kufizohet vetëm në një raportim jofinanciar të kufizuar.

Një ndryshim i dytë është përfshirja në ligj e detyrimit për raportimin publik të informacionit mbi tatimin mbi të ardhurat (Country-by-Country Reporting), në përputhje me Direktivën (BE) 2021/2101. Ky raportim do të bëhet vetëm prej njësive ekonomike që operojnë në më shumë se një juridiksion dhe që, në dy periudhat e fundit raportuese të njëpasnjëshme, kanë realizuar të ardhura të konsoliduara që tejkalojnë shumën prej 750 milion euro. Qëllimi i këtij raportimi është rritja e transparencës fiskale dhe forcimi i luftës kundër shmangies tatimore, duke siguruar një pasqyrë të qartë mbi vendin ku krijohet fitimi dhe ku paguhen tatimet.

Përveç ndryshimeve të mësipërme, janë propozuar nga Këshilli edhe një sërë ndryshimesh teknike dhe qartësuese, të cilat synojnë përmirësimin e zbatueshmërisë së ligjit në praktikë. Këto ndryshime lidhen, ndër të tjera, me rregullat për konsolidimin e pasqyrave financiare, heqjen e detyrimeve të panevojshme rregullatore që nuk burojnë nga standardet e raportimit financiar, zbatueshmërinë e disa kërkesave të ligjit lidhur me publikimin e pasqyrave si dhe përmirësime të tjera me qëllim unifikimin e terminologjisë në funksion të rritjes së sigurisë juridike dhe shmangies së paqartësive në zbatim.

4. Rishikimi i kërkesës ligjore për personin përgjegjës për pasqyrat financiare

Në kuadër të ndryshimeve të ligjit të kontabilitetit, Këshilli ka vlerësuar shqetësimin e ngritur nga shoqatat e profesionit të auditimit dhe kontabilitetit lidhur me zbatimin e kërkesës së parashikuar në këtë ligj në nenin 23, pika 3 e tij. Këshilli ka organizuar takime me përfaqësues të QKB-së dhe shoqatave të profesionit për të mundësuar identifikimin e qasjeve që mundësojnë zbatimin korrekt të kësaj kërkesë ligjore. Puna në këtë drejtim ka vijuar dhe në vitin 2026.

5. *Analiza dhe përgatitja e relacionit për ministrin përgjegjës për financat në lidhje me kërkesën e AMF, rregullatori i tregut të sigurimeve, për shtyrjen e afatit të zbatimit të SNRF 17*

Me kërkesë të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, u iniciua diskutimi mbi mundësinë e shtyrjes së afatit të zbatimit të SNRF 17 “Kontratat e Sigurimeve”. Argumentet e parashtruar nga AMF ishin si më poshtë:

- a) Në Rregulloren No 1606/2022 të Këshillit Europian parashikohet që çdo vend anëtar mund të lejojë ose kërkojë zbatimin e detyrueshëm të SNRF-ve për kompanitë e palistuara në bursë (pra shtetet anëtare kanë autonominë e vendimmarrjes për kompanitë e palistuara në lidhje me shmangien nga zbatimi i detyrueshëm i SNRF-ve);
- b) Udhëzimi nr. 146 datë 31.08.2023 kërkon kohë për t’u zbatuar korrektësisht nga shoqëritë e sigurimeve në vend për shkak të shkallës së lartë të kompleksitetit;
- c) Trajnimet e dedikuara për implementimin e SNRF 17 në kuadër të projektit SQARP janë efektive por të zhvilluara së fundmi nuk u’a mundësojnë stafeve implementimin e menjëhershëm të SNRF 17;
- d) Përputhja e afateve të implementimit të kërkesave teknike të udhërrëfyesit drejt Solvency dhe kërkesave të SNRF 17 “Kontratat e Sigurimeve”.

Këshilli, në zbatim të detyrës që i ngarkon ligji i kontabilitetit në nenin 24, pika 2 (a) përgatiti një relacion sqarues për Ministrin përgjegjës për financat, i cili është autoriteti që shpall të detyrueshme për zbatim standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të raportimit financiar.

6. *Hartimi i metodologjisë së monitorimit dhe miratimi i saj*

Këshilli, gjatë vitit 2025 miratoi Metodologjinë e Monitorimit të pasqyrave financiare të njësisve ekonomike. Metodologjia synon përzgjedhjen e kampionit mbi baza risku dhe më pas identifikimin e problematikave dhe mangësive me qëllim:

- Në rastin e pasqyrave financiare të hartuara sipas SKK-ve: përmirësimin e kuadrit të raportimit financiar përmes hartimit të standardeve të reja apo publikimit të Udhëzuesve në zbatim të standardeve;
- Në rastin e pasqyrave financiare të hartuara sipas SNRF-ve: komunikimin me njësitë ekonomike apo rregullatorët e tyre për përmirësimin e raportimit financiar dhe transparencës për publikun.

Metodologjia u implementua me sukses gjatë vitit 2025 dhe stafi mbështetës realizoi monitorimin e 98 pasqyrave financiare, të hartuara për periudhën kontabël 2024.

7. *Komiteti i Rishikimit*

Pranë Këshillit Kombëtar të Kontabilitet ngrihet dhe funksionon Komiteti i Rishikimit i cili ka si detyrë përkthimin nga origjinali dhe rishikimin e përkthimit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Ky Komitet ka mandat 2 vjeçar dhe përbëhet nga katër anëtarë, dy Përkthyes (që ofrojnë shërbim me pagesë) dhe dy Rishikues (që ofrojnë shërbim pa pagesë).

Në vitin 2025 u mandatua Komiteti i Rishikimi me mandat 2025-2026 me këtë përbërje:

Iris Qirjaqi, Rishikues

Enida Cara, Rishikues

Valbona Kapllani, Përkthyes

Kledian Kodra, Përkthyes

8. *Koordinimi për përkthimin e Standardeve ESRs*

Me mbështetjen financiare të Bankës Botërore dhe SECO, nën koordinimin e punës nga stafi mbështetës i KKK-së, u realizua përkthimi i standardeve të raportimit të qëndrueshmërisë të cilat janë hartuar nga EFRAG¹ dhe të publikuara në faqen zyrtare të Komisionit Europian². Standardet e qëndrueshmërisë, të përkthyer në gjuhën shqipe, janë publikuar në faqen zyrtare të Institutit të Ekspertëve të Autorizuar IEKA³.

9. *Përgatitja periodike e raportimeve për Ministrinë e Financave:*

- Progres-Raportit, përsa i përket Kap.6 - Accounting & Auditing;
- Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2024–2026 dhe finalizimin e PKIE 2026;
- Paketës së Raportit Kombëtar të Veprimtarisë GNPIE & Vlerësimit të Indeksit të Kapaciteteve të Integritimit Evropian;
- Planit Menaxherial të Integritimit Evropian për Forcimin e Kapaciteteve Administrative për vitin 2026, (PSIE 2025);

¹ European Financial Reporting Advisory Group

² <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:02023R2772-20231222>

³ <https://ieka.al/a-e-dini-se-cilat-kushte-duhet-te-permbushe-nje-auditues-ligjor-per-te-dhene-sherbime-sigurie-nelidhje-me-raportimin-e-qendrueshmerise/>

10. Raporti i veprimtarisë për vitin 2024

Në përputhje me ligjin e kontabilitetit, neni 27(1) dhe 27(2) ka përgatitur dhe publikuar në faqen e internetit, Raportin e veprimtarisë për vitin 2024. Raporti, pjesa ku trajtohen me hollësi problemet e konstatuara gjatë monitorimeve në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare, si dhe zgjidhjet e sugjeruara, i është dërguar për informacion Bordit të Mbikëqyrjes Publike, brenda afatit të pikës 1, të këtij neni.

11. Kontribut mbi transpozimin e Direktivave të BE lidhur me Kapitullin 6 “Ligji për Shoqëritë tregtare”, Kontabiliteti dhe Auditimi.

Përfshirja dhe kontributi në të gjitha tavolinat e punës të organizuar nga Negociatori me objekt përmbyllja e transpozimit të Direktivave të BE lidhur me Kapitullin 6 “Ligji për Shoqëritë tregtare”, çështjet për kontabilitetin dhe auditimin.

12. Hartimi dhe miratimi i programit të punës për vitin 2026

3 Informacion mbi SKK-të dhe SNRF-të

3.1 Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të)

a) Standardi Kombëtar i Kontabilitetit 8 “Të ardhurat”

Në shkurt të vitit 2025, IFRS Foundation, publikoi edicionin e tretë të SNRF për NjVM. Në këtë edicion një nga ndryshimet themelore është seksioni 23 "Të ardhurat" i cili është një trajtim i thjeshtuar i SNRF 15 "Të ardhurat". Meqenëse krijohet një mospërputhje e qenësishme mes trajtimit të të ardhurave sipas SKK 8 versus Seksioni 23 (SNRF për NjVM), atëherë Këshilli vendosi rishikimin e plotë të SKK 8 “Të ardhurat”.

Ka përfunduar tabela krahasuese mes paragrafëve të SKK 8 dhe SEK 23 të SNRF për NjVM. Ky material i përgatitur është baza mbi të cilën Këshilli gjykon lidhur me ndryshimet e mundshme të standardit dhe diskutimet kanë vijuar edhe në vitin 2026. Programi i punës, i vitit 2026, parashikon publikimin për komente të draftit të SKK 8 në fillim të 6-mujorit të dytë të vitit 2026.

b) Udhëzuesi për SKK 8 “Të ardhurat”

Pavarësisht projektit të ndërmarrë për rishikimin thelbësor të SKK 8 “Të ardhurat”, në të njëjtën kohë Këshilli ndërmori gjatë vitit 2025 iniciativën për plotësimin e Udhëzuesit të SKK 8 që është aktualisht e detyrueshme për zbatim. Ky përmirësim i udhëzuesit aktual synon të adresojë çështje të raportimit financiar lidhur me njohjen dhe matjen e të ardhurave nga kontratat e ndërtimit. Kjo nevojë ka lindur si kërkesë e shoqërive që operojnë në këtë sektor por dhe e përdoruesve të ndryshëm të pasqyrave të këtyre njësive ekonomike.

Drafti i ndryshimit të Udhëzuesit të SKK 8 përfundoi në tre mujorin e parë të vitit 2026 dhe dokumenti po përgatitet për t’u publikuar për komente në faqen zyrtare të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

3.2 Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNRF-të)

a) Përkthimi i ndryshimeve vjetore të SNRF-ve

Në vitin 2025 janë përkthyer, rishikuar dhe miratuar në KKK materialet e reja të SNRF-ve vënë në dispozicion të Këshillit nga IFRS Org sipas kontratës mes Qeverisë shqiptare përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, Londër.

Titulli	Data Efektive	Shpallur me Urdhër të Ministrit të Financave
Kontratat që i Referohen Energjisë Elektrike në varësi të Natyrës <i>Ndryshime të SNRF 9, SNRF 7 dhe SNRF 19</i>	Më 1 janar 2026	Nr.139, dt. 04.11.2025
Filialet pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese <i>Ndryshime të SNRF 19, SNRF 7, SNRF 18, SNK 7, SNK 12, SNK 21, SNRF 5, SNRF 17</i>	Më 1 janar 2027	Nr. 160, dt. 22.12.2025
Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit të Monedhave të Huaja <i>Ndryshime në SNK 21, SNRF 19, SNK 29</i>	Më 1 janar 2027	Nr.13, dt. 23.01.2026

b) Përgatitja e variantit të konsoliduar të SNRF-ve

Në datë 09 prill 2025, BSNK, në përputhje me termat e kontratës, dërgoi materialin Red Book 2025. Përgatitja e variantit të konsoliduar 2025 të SNRF-ve në gjuhën shqipe, u bë përmes programit TRADOS nga Inspektori për SNRF-të.

Si procedurë, në variantin e konsoliduar të vitit 2025 përfshihen SNRF-të e publikuara nga BSNK deri në dhjetor të vitit 2024. Varianti i konsoliduar 2025 përfundoi brenda muajit korrik 2025 dhe u dërgua për aprovim në BSNK. Konfirmimi me email erdhi nga stafi i BSNK brenda muajit korrik 2025. Varianti i konsoliduar 2025 është publikuar në faqen e internetit të KKK-së (<https://kkk.gov.al/standardet-nderkombetare-te-kontabilitetit-dhe-raportimit-financiar>)

4 Gjetje nga monitorimi i pasqyrave financiare

Në zbatim të kërkesës së ligjit 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 27, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit raporton në lidhje me problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të pasqyrave financiare. Për sigurimin e pasqyrave financiare dhe raporteve të tjera të publikuara nga njësitë ekonomike, pjesë të kampionit që monitorohet, stafi logohet në portalin e QKB-së. Kjo është baza shkresore mbi të cilën stafi punon për të monitoruar pasqyrat dhe evidentuar rastet kur ka problematika të zbatimit të standardeve apo respektimit të kërkesave ligjore lidhur me raportimin financiar.

Sipas ligjit për kontabilitetin, të gjitha njësitë ekonomike e organizojnë mbajtjen e kontabilitetit dhe raportimin financiar mbi bazën e parimeve dhe metodave që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ose Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në varësi të kritereve që përmbushin për periudhën/at raportuese.

Në vitin 2025, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK) nga komunikimi me Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) ka siguruar informacion statistikor të rëndësishëm në grupimin e njësive ekonomike sipas treguesit të të ardhurave në pasqyrat financiare të njësive ekonomike. Tre grupet ndahen në:

- Njësitë ekonomike me të ardhura nga veprimtaria deri në 50 milion lekë;
- Njësitë ekonomike me të ardhura nga veprimtaria deri në 500 milion lekë, dhe
- Njësitë ekonomike me të ardhura nga veprimtaria deri në 2.5 miliard lekë.

QKB mundësoi listën me NIPT-e të njësive ekonomike të përzgjedhura sipas kriterëve të përcaktuara. Më pas, Inspektori për monitorimin, përmes tool kit që shoqëron metodologjinë e monitorimit të bazuar në risk, përcaktoi pasqyrat financiare për t'u përfshirë në monitorimin e vitit 2025, duke siguruar një kampionim të balancuar sektorëve ku operojnë njësitë ekonomike të përzgjedhura në procesin e monitorimit.

Të përgjithshme mbi monitorimin e pasqyrave financiare gjatë vitit 2025

Kampioni i përzgjedhur i pasqyrave financiare, përfaqësohet nga pasqyra të njësive ekonomike të mesme dhe të mëdha, ku është dhe interesimi më i lartë në cilësinë e raportimit për qëllime të cilësisë së vendimmarrjes ekonomike por dhe të rritjes së transparencës së informacionit financiar për përdoruesit e tij.

Nëpërmjet monitorimit, është synuar verifikimi i përputhshmërisë së pasqyrave me:

- kërkesat e parashikuara në standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit;
- kërkesat e parashikuara në ligjin për kontabilitetin për dhënien e shënimeve shpjeguese dhe publikimin e raporteve të tjera që shoqërojnë pasqyrat financiare

Monitorimi i pasqyrave synon identifikimin e problematikave në lidhje me zbatimin e kërkesave të standardeve dhe atyre ligjore por me synimin për të plotësuar kuadrin rregullator me akte ligjore, nënligjore dhe udhëzues në zbatim të standardeve, dokumente të cilat rrisin nivelin e ekspertizës në komunitetin e profesionistëve kontabël por edhe të përdoruesve të këtyre pasqyrave.

Bazuar në të dhënat e shifrës së afarizmit, totalit të aktivitetit dhe numrit të të punësuarve, është bërë një klasifikim i njësive ekonomike e më pas një vlerësim i përputhshmërisë me kërkesën për zbatimin e standardeve përkatëse të detyrueshme për hartimin e pasqyrave financiare, si dhe është analizuar saktësia dhe besueshmëria e informacionit të paraqitur. Monitorimi ka synuar të evidentojë çdo devijim të mundshëm nga kërkesat ligjore dhe të sigurojë që njësitë ekonomike të reflektojnë në mënyrë të drejtë aktivitetin e tyre ekonomik përmes pasqyrave financiare.

Në shtojcën D që shoqëron këtë Raport është paraqitur lista e informacioneve dhe shpjegimeve që monitorohen për të kuptuar pajtueshmërinë e pasqyrave të publikuara me setin e standardeve të raportimit financiar me të cilat ato janë hartuar si dhe me kërkesat ligjore.

Kriteret e klasifikimit të njësive ekonomike në periudhën kohore 2022 – 2024, janë si më poshtë vijon:

Njësi ekonomike të mëdha

Aktivitet $\geq 1,250,000,000$

Të ardhura nga veprimtari ekonomike $\geq 2,500,000,000$

Numri i punonjësve ≥ 250

Njësi ekonomike të mesme

Aktivitet $\leq 1,250,000,000$

Të ardhura nga veprimtari ekonomike $\leq 2,500,000,000$

Numri i punonjësve ≤ 250

Konkretisht, gjatë vitit 2025 janë monitoruar pasqyrat financiare të vitit 2024. Për vitin 2025 janë shkarkuar nga portali i QKB-së pasqyrat dhe raportet e tjera për 98 (nëntëdhjetë e tetë) njësi ekonomike. Më poshtë jepen disa karakteristika të kampionit të përzgjedhur në monitorim:

Klasifikimi sipas madhësisë

Të monitoruara	Gjithsej
Njësi ekonomike të mëdha	46
Njësi ekonomike të mesme	40
Nuk mund të përcaktohet	12
Total njësi ekonomike	98

Klasifikimi sipas formës ligjore (ky informacion është marrë në Ekstraktin Historik të subjekteve)

Të monitoruara	Gjithsej
Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SHPK)	60
Shoqëri aksionare (SHA)	32
Degë të shoqërive të huaja	4
Person Fizik	1
I papërcaktuar	1
Total njësi ekonomike	98

Njësitë ekonomike të monitoruara paraqiten gjithashtu të ndara sipas sektorëve të veprimtarisë, duke përfshirë tregtinë, shërbimet, industrinë e prodhimit dhe sektorin bankar. Ky klasifikim lejon një vlerësim më të qartë të përputhshmërisë me detyrimet ligjore në çdo industri dhe ndihmon në identifikimin e trendeve dhe sfidave specifike për secilin sektor.

Klasifikimi sipas objektit të veprimtarisë

Të monitoruara	Gjithsej
Tregti	45
Shërbim	23
Ndërtim	12
Prodhim	9
Bankë	5
Prodhim (Hidrocentrale)	2
Turizëm	2
Total njësi ekonomike	98

Nga procesi i monitorimit rezulton se, nga totali i njërive ekonomike të analizuara, janë evidentuar 4 subjekte fitimprurëse në sektorin publik të cilat nuk kanë depozituar pasqyrat financiare vjetore pranë QKB-së, pavarësisht se hartimi dhe depozitimi i tyre përbën detyrim ligjor në fuqi.

Gjithashtu, është konstatuar se gjatë vitit 2025 janë depozituar pasqyra financiare të prapambetura, të cilat i përkasin periudhës 2021–2023, të cilat përbëjnë shkelje të kërkesave ligjore dhe afateve të përcaktuara për raportimin financiar.

Gjetje lidhur me raportet e tjera që shoqërojnë pasqyrat financiare:

Evidentohet se 99% e kampionit të monitoruar plotëson kriteret për Auditim Ligjor, nisur nga shifra e afarizmit, totali i aktivitet apo numri i të punësuarve (2 nga 3 kriteret). Duke qenë se kampioni në 99% të tij plotëson kriteret për njësi ekonomike të mesme ose të mëdha, atëherë këtyre shoqërive, ju lind edhe detyrimi për hartimin dhe publikimin e raporteve të tjera.

Më poshtë disa gjetje që i referohen rast pas rasti secilit prej raporteve që shoqërojnë pasqyrat:

Shënime shpjeguese (të publikuara)

Njësiti ekonomike të mëdha	70%
Njësiti ekonomike të mesme	50%

Raporti i veprimtarisë (i publikuar)

Njësiti ekonomike të mëdha	86%
Njësiti ekonomike të mesme	40%

Raport auditimi (i publikuar)

Njësiti ekonomike të mëdha	70%
Njësiti ekonomike të mesme	35%

Raporti jofinanciar (i publikuar)

Njësiti ekonomike të mëdha që e kanë publikuar	44%
Njësiti ekonomike të mëdha që nuk e kanë publikuar	56%

Raporti i drejtimit të brendshëm (i publikuar)

Njësiti ekonomike të mëdha që e kanë publikuar	50%
Njësiti ekonomike të mëdha që nuk e kanë publikuar	50%

Raporti i deklarimit të pagesave ndaj inst shtetërore (i publikuar)

Njësiti ekonomike të mëdha që e kanë publikuar	35%
Njësiti ekonomike të mëdha që nuk e kanë publikuar	65%

Një tjetër gjetje e rëndësishme e monitorimeve është respektimi i kërkesës ligjore për setin e standardeve të zbatueshme.

Sipas madhësisë	SKK	SNRF	Gjithsej
Të mesme	35	5	40
Të mëdha	8	38	46
Të papërcaktuara	8	4	12
TOTALI	51	47	98

Nga monitorimi rezulton se ekziston problematikë në zbatimin e standardeve kontabël në 8 (tetë) prej njësive ekonomike të klasifikuara si të mëdha pasi këto subjekte zbatojnë setin e SKK-ve në kundërshtim me rregullimet në ligjin për kontabilitetin. Stafi i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (KKK) ndjek komunikim me këto subjekte për të thelluar informacionin e mbledhur dhe për të sqaruar pozicionin e tyre në raport me kërkesat ligjore.

Nga ana tjetër, është vërejtur një zbatim vullnetar i SNRF-ve nga një grup i njësive ekonomike të mesme 5 (pesë) prej tyre, të cilat nuk i tejkalojnë kufijtë e përcaktuar për zbatimin e SKK-ve. Në komunikimet e mëtejshme me këto subjekte, stafi i KKK-së do të përcaktojë nëse ky zbatim është rezultat i kërkesës së ortakëve/aksionerëve të shoqërive apo nëse bëhet fjalë për njësi të kontrolluara nga shoqëri të huaja që raportojnë sipas kërkesave të grupit ku janë pjesë.

Një tjetër problematikë e hasur gjatë këtij monitorimi është edhe mospërputhja midis shënimeve shpjeguese të njësive ekonomike dhe raportit të auditimit. Disa subjekte përkatësisht 12 (subjekte) kanë deklaruar në shënimet shpjeguese setin e zbatuar të Standardeve ndryshe nga sa konfirmohet në raportin e auditimit.

Gjithashtu, përveç sa më sipër është vënë re se, në disa raste, krahas publikimit të pasqyrave financiare për vitin 2024, është bashkëngjitur opinionin e audituesit për vitin 2023. Kjo krijon një konfuzion të dukshëm për përdoruesit e pasqyrave financiare, pasi opinionin e auditimit nuk i korrespondon vitit të raportuar dhe mund të japë një pamje të pasaktë të performancës aktuale financiare të subjektit.

Një situatë e tillë tregon mungesë koordinimi në përgatitjen dhe publikimin e dokumentacionit financiar dhe mund të ndikojë në besueshmërinë e raportimit, duke rritur rrezikun për interpretim të gabuar nga investitorët, autoritetet tatimore dhe palët e tjera të interesuara. Për më tepër, kjo tregon nevojën për forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit nga ana e QKB-së, për të siguruar që çdo pasqyrë financiare të publikohet me opinionin e auditimit përkatës dhe për vitin që i përket, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e raportimit financiar.

Gjithashtu, 25 (njëzetepesë) pasqyra financiare të mbyllura për vitin 2024 rezultojnë të kenë shënimin e gabuar se janë përgatitur në përputhje me Ligjin e mëparshëm për kontabilitetin nr. 9228, datë 29.04.2004, i cili është shfuqizuar. Kjo tregon një moszbatim të kërkesave ligjore aktuale dhe rrit rrezikun e mospërputhshmërisë me standardet e raportimit financiar. Përveç kësaj, përdorimi i një legjislacioni të vjetër mund të ndikojë në saktësinë dhe transparencën e informacionit financiar të publikuar, duke e bërë më të vështirë krahasimin me pasqyrat financiare të periudhave të tjera dhe duke cënuar besueshmërinë për autoritetet, investitorët dhe palët e tjera të interesuara. Për këtë arsye, është e domosdoshme që të gjitha njësive ekonomike të përditësojnë bazën ligjore dhe nënligjore të përgatitjes së pasqyrave financiare.

Një kriter tjetër shumë i rëndësishëm për monitorimin e njësive ekonomike është publikimi i numrit të punonjësve në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Ky informacion është thelbësor për klasifikimin e njësive dhe për verifikimin e përmbushjes së detyrimeve ligjore për raportim financiar. Mos-dhënia e këtij informacioni pengon vlerësimin e saktë të kategorisë së klasifikimit të njësive.

Nga monitorimi kemi këto statistika:

Njësi ekonomike të monitoruara	Gjithsej
Të cilët kanë deklaruar numrin mesatar të punonjësve	62
Të cilët nuk kanë deklaruar numrin mesatar të punonjësve	36
TOTAL	98

Ndër 36 njësitë që nuk kanë dhënë në shënime numrin e të punësuarve, rezulton se 9 prej tyre janë njësi ekonomike të mëdha. Në 27 njësitë e tjera, mungesa e numrit të të punësuarve vë në diskutim 12 prej tyre, të cilat plotësojnë vetëm njërin kriter për të qenë të mëdha dhe e bën të papërcaktueshëm vlerësimin e madhësisë së njësisë ekonomike.

Nënshkrimi i pasqyrave financiare

Sipas ligjit 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 23, pika 3 kërkon që pasqyrat financiare të nënshkruhen nga përfaqësuesi ligjor i njësisë ekonomike dhe personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare. Nga monitorimi i njësisë që kanë hartuar dhe publikuar pasqyra financiare konstatojmë në mënyrë të përsëritur se jo të gjitha njësitë ekonomike e kanë zbatuar këtë kërkesë të ligjit.

	Përfaqësuesi ligjor dhe personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave	Administratori
Njësi ekonomike të mëdha	32	0
Njësi ekonomike të mesme	12	8
Total	44	8

Gjetje për shënimet shpjeguese

Roli i shënimeve shpjeguese të pasqyrave financiare është thelbësor për të kuptuar në mënyrë të plotë dhe të saktë gjendjen financiare dhe performancën e njësive ekonomike. Ndërkohë që nga pasqyrat financiare të pozicionit, performancës dhe fluksit të parasë marrim në vlerësim një informacion të përmbledhur dhe numerik, shënimet shpjeguese na ofrojnë kontekstin dhe detajet e nevojshme për interpretimin e tyre.

Shënimet shpjeguese sqarojnë politikat kontabël të përdorura nga njësia ekonomike. Kjo është shumë e rëndësishme, pasi metoda të ndryshme kontabël mund të çojnë në rezultate të ndryshme financiare. Duke ditur se cilat standarde dhe politika kontabël janë ndjekur, përdoruesit e pasqyrave financiare mund të bëjnë krahasime më të drejta dhe të informuara. Rezulton që në 12 njësi ekonomike ka kundërshti mes sa thuhet në shënime shpjeguese dhe sa thuhet në raportin e auditimit lidhur me setin e standardeve të zbatuara e për rrjedhojë edhe të politikave kontabël të aplikuara.

Shënimet shpjeguese japin informacion të detajuar për zërat kryesorë të pasqyrave financiare. Kjo rrit transparencën dhe ndihmon përdoruesit e pasqyrave financiare të kuptojnë burimet dhe detyrimet e njësisë ekonomike. Na rezulton se janë publikuar shënimet e 32 njësive ekonomike të mëdha (70%) dhe të 20 njësive ekonomike të mesme (50%).

Referuar shënimeve shpjeguese të njësive ekonomike të mëdha, të publikuara, rezulton që ka një prirje të jenë më të plota dhe më të shtjelluara. Por vijon të përsëritet në disa raste fenomeni që shënimet shpjeguese nuk janë pjesë e paketës së dokumentacionit të paraqitur nga vetë njësia ekonomike por i gjejmë si pjesë të raportit të auditimit. Gjithashtu është dominues fenomeni që shpjegimet e politikave kontabël apo çmuarjeve janë paragrafë identikë të Standardeve dhe jo shtjellime të aplikimit të tyre në pasqyrat financiare. Rëndom gjen tek shënimet që jepen shpjegime lidhur me zëra që nuk janë fare pjesë e pasqyrave në fjalë si psh, shënime për provizionet, qiratë financiare, instrumentet financiare derivativë, etj.

Referuar njësive ekonomike të mesme vërehen mangësi të konsiderueshme në disa drejtime:

- niveli 50% i njësive ekonomike që nuk kanë paraqitur shënime shpjeguese është tregues që e bën Këshillin të reflektojë dhe të kërkojë të kuptojë arsyen e një shmangie të tillë. Nëse arsyeja është vështirësia e përgatitjes së tyre atëherë i del detyrë Këshillit që në periodat në vijim të hartojë udhëzues të tjerë për përgatitjen e shënimeve. Nëse kjo mangësi e ka burimin tek mungesa e vullnetit të njësive ekonomike për të shpjeguar informacionin ose tek neglizhenca sepse ligji nuk shoqërohet me masa ndëshkuese atëherë ndërhyrja kërkon rishikim të akteve ligjore apo nënligjore. Por nëse arsyeja është se njësive ekonomike u rezulton që nuk ka përdorues të interesuar për shënimet e tyre atëherë ndoshta duhet kuptuar më thellë problemi për të gjetur për çfarë janë të interesuar përdoruesit e pasqyrave financiare dhe deri në çfarë mase.
- pjesa tjetër e njësive ekonomike të mesme që i kanë publikuar shënimet shpjeguese ndahen në dy kategori: shënime pjesërisht të plota por që respektojnë vetëm disa nga kriteret e kërkuara për shënime cilësore dhe pjesa tjetër, por jo e vogël, kanë publikuar shënime shpjeguese të një niveli aspak dinjitoz. Për këto të dytat konstatohet se shënimet janë të përmbledhura vetëm në disa rreshta që nuk flasin për asgjë, kanë referenca të gabuara të akteve ligjore apo të standardeve, kanë thjesht riparazitje të seksioneve numerike të pasqyrave, përmendin kuadrin ligjor fiskal dhe rregullimet e tij (sidomos kur flasin për amortizimin) si kuadër të politikave kontabël dhe më shpesh e hasura është praktika e një “copy – paste” uniform të paragrafëve të shënimeve shpjeguese nga njëra njësi tek tjetra.

Shënimet shpjeguese japin informacione mbi rreziqet dhe pasiguritë, siç janë angazhimet jashtë pasqyrës së pozicionit, çështjet ligjore apo detyrimet e kushtëzuara. Këto elemente mund të mos pasqyrohen drejtpërdrejt në shifrat kryesore, por kanë ndikim të rëndësishëm në vendimmarrje. Nuk gjejmë në asnjë rast të shpjegohen p.sh, nëse njësitë ekonomike janë të përfshirë në ndonjë çështje gjyqësore, nëse kanë marrë hua dhe kanë riskeduluar planin e pagesave, nëse kanë pasiguri lidhur me riskun e kursit të këmbimit, nëse kanë bërë teste zhvlerësimi për shumën e rikuperueshme të aktiveve afatgjata, nëse kanë përdorur dhe si e kanë përdorur gjykimin për çmuarjet që kanë bërë, e të tjera situata si këto.

Në përfundim, shënimet shpjeguese janë një pjesë integrale e raportimit financiar. Ato sigurojnë transparencë, rrisin besueshmërinë e informacionit dhe ndihmojnë përdoruesit të marrin vendime më të sakta ekonomike. Pa to, pasqyrat financiare do të ishin të paplota dhe më të vështira për t'u interpretuar drejt. Në këto kushte, rezulton që cilësia e raportimit financiar është në nivele të pakënaqshme, sidomos për njësitë ekonomike të mesme. Ky përfundim nuk mund të përgjithësohet por i referohet vetëm kampionit të marrë për monitorim.

5 Plani i punës për vitin 2026

Në mbledhjen e muajit dhjetor, Këshilli diskutoi në parim programin e punës për vitin pasardhës 2026. Programi i hartuar synon përmbushjen e të gjitha detyrave të caktuara me ligj apo me akte të tjera nënligjore dhe përmban detyrat si më poshtë:

1. Publikimi i teksteve të SKK-ve dhe Udhëzuesve në zbatim të tyre;
2. Miratimi i SKK 8 “Të ardhurat”, i rishikuar sipas seksionit 19 të SNRF për NjVM;
3. Draftimi i ndryshimeve të SKK 9 “Kombinimi i Bizneseve dhe Pasqyrat e Konsoliduara” i rishikuar sipas seksionit 19 të SNRF për NjVM;
4. Përkthimi i SNRF-ve dhe përgatitja e variantit të konsoliduar 2026;
5. Monitorimi i pasqyrave financiare të njësive ekonomike (pasqyrat të vitit 2024&2025) duke vënë në zbatim metodologjitë e reja të adoptuara nga Këshilli për monitorimin e pasqyrave financiare;
6. Organizimi i dy tryezave të rrumbullakëta – aktiviteti i parë me qëllim për të prezantuar tek palët e interesuara ndryshimet e ligjit për kontabilitetin (që pritet të miratohet në 6-mujorin e parë të vitit 2026) dhe aktiviteti i dytë me qëllim prezantimin e SKK 8 “Të ardhurat” i rishikuar.

7. Përfshirja në dhënie mendimi për akte ligjore dhe nënligjore si dhe përgatitja e të gjitha informacioneve të kërkuara nga Negociatorët dhe KryeNegociatori në lidhje me procesin e transpozimit të Direktivave të BE (acquis communitaires) në kuadër të procesit të integritit të Shqipërisë në BE.
8. Intensifikimi i komunikimit me publikun duke zgjeruar rrjetet sociale të komunikimit dhe përmirësimin e faqes së internetit për të mundësuar një gjë të tillë.

6 Çështje të tjera për rritjen e kapaciteteve dhe efektivitetit të punës së KKK-së

Mbetet një çështje shumë e rëndësishme në Këshill plotësimi i organikës me staf të kualifikuar në fushën e jurisprudencës pasi shumë diskutime që bëhen kërkojnë jo vetëm zgjidhjen kontabël por dhe vlerësimin e ndikimit të tyre nga pikëpamja juridike.

Gjithashtu, në përgjigje të dinamikave të digitalizimit të të gjitha proceseve, stafi duhet plotësuar edhe me kapacitetet e nevojshme në fushën e IT.

Për sa më sipër kërkohet mbështetje nga Ministria e Financave në hartimin e projekt akteve nënligjore për të adresuar nevojat e Këshillit për organikën dhe logjistikën.

Në vijim, gjatë vitit 2025 në Këshill u krijua një vakancë për pozicionin Inspektor për SKK-të për arsye të daljes në pension. Në vitin 2026 është shpallur njoftimi për hapjen e aplikimeve.

Shtojcë A- Realizimi i treguesve të buxhetit dhe veprimtaria financiare për vitin 2025

Në bazë të Ligjit Nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025” dhe Udhëzimin Plotësues Nr.2 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, buxheti i miratuar për vitin 2025 për KKK, paraqitet si më poshtë vijon:

Emërtimi i institucionit		Llog. Ekonomike		Plani i vitit 2025 në lekë
1	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	600	Pagat	10,910,000
2	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	601	Sig. Shoqërore	1,800,000
3	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	602	Shpenzime Operative	4,040,000
4	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	605	Transferta korrente të huaja	600,000
5	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	606	Transferta për buxhetet familjare dhe individët	200,000
6	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	231	Investime	1,000,000
TOTALI				18,550,000

Buxheti i rishikuar dhe i miratuar për vitin 2025 për KKK, me shkresën e Ministrisë së Financave nr.2605 prot, datë 06.02.2025, paraqitet si më poshtë vijon:

SHTESA	Vlera (lekë)
Llogaria buxhetore 606 Transferta për buxhetet familjare dhe individët	100,000

Emërtimi i institucionit		Llog. Ekonomike		Plani i vitit 2025 në lekë
1	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	600	Pagat	10,910,000
2	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	601	Sig. Shoqërore	1,800,000
3	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	602	Shpenzime Operative	4,040,000
4	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	605	Transferta korrente të huaja	600,000
5	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	606	Transferta për buxhetet familjare dhe individët	300,000
6	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	231	Investime	1,000,000
TOTALI				18,650,000

Sipas informacionit të raportuar në Degën e Thesarit, Tiranë shpenzimet e kryera për investime për vitin 2025, janë si më poshtë:

Përshkrimi	Tipi	Fondi i përlogaritur	Fondi i përdorur	% e realizimit
Pajisje informatike	Investime (Llog 231)	1,000,000	92,000	9,2%
TOTALI		1,000,000	92,000	9,2%

Realizimi i buxhetit të shpenzimeve për paga për vitin 2025 paraqitet si vijon:

Llog. Ekonomike	Viti 2025		
	Plani	Fakti	%
Pagat llog 600	10,910,000	8,523,101	78,12%
Sig.shoq llog 601	1,800,000	1,403,263	77,95%
Totali	12,710,000	9,926,364	78,09%

Shpenzimet rrjedhëse dhe blerjet me vlerë të vogël paraqiten si më poshtë:

Përshkrimi	Tipi	Fondi i përlogaritur	Fondi i përdorur	% e realizmit
Tarifa IASB, Londër	Transf. ndërkombëtare	600,000.00	519,641.00	86.61%
Honorare të Anëtarëve	Shpenzim standard	1,320,000.00	1,035,750.00	78.47%
Shpenzime postare	Shpenzim utilitar	4,000.00	890.00	22.25%
Pastrim zyresh	Prokurim me vlerë të vogël	200,000.00	152,880.00	76.44%
Dosje arkivi (Ligji i Arkivave)	Marrëveshje kuadër	500,000.00	174,725.00	34.95%
Kancelari	Blerje nën 100.000 leke	120,000.00	119,871.00	99.89%
Shërbim interneti	Blerje nën 100.000 leke	120,000.00	87,600.00	73.00%
Mirëmbajtje faqe web	Blerje nën 100.000 leke	110,000.00	89,640.00	81.49%
Riparime sistemi elektrik	Blerje nën 100.000 leke	120,000.00	118,200.00	98.50%
Mirëmbajtje dhe riparime të tjera	Blerje nën 100.000 leke	50,000.00	46,250.00	92.50%
Shtesë fuqie OSHEE	Blerje nën 100.000 leke	40,000.00	35,745.00	89.36%
